LIGJ
Nr.10 187, datë 12.11.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR THJESHTIMIN E PROCEDURAVE TË VIZAVE PËR SHOFERËT PROFESIONISTË TË KAMIONËVE, SHTETAS TË VENDEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK TË DETIT TË ZI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja për thjeshtimin e procedurave të vizave për shoferët profesionistë të kamionëve, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6348, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
PËR THJESHTIMIN E PROCEDURAVE TË VIZAVE PËR SHOFERËT PROFESIONISTË TË KAMIONËVE, SHTETAS TË VENDEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK TË DETIT TË ZI

Qeveritë e mëposhtme nënshkruese (të referuara më poshtë si palët kontraktuese), në cilësinë e qeverive të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi;

duke marrë parasysh nenin 6 të "Memorandumit të mirëkuptimit për lehtësimin e transportit rrugor të mallrave në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim të Detit të Zi", të nënshkruar në Kiev më 6 mars 2002, në veçanti paragrafin 2 të tij;

duke qenë të bindura se thjeshtimi i procedurave të vizave për shoferët profesionistë të kamionëve, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, do të përshpejtojë zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Secila palë kontraktuese, nëpërmjet autoriteteve kompetente kombëtare të caktuara për këtë qëllim, mund të hartojë, veçmas për çdo palë kontraktuese, listën kombëtare të shoferëve profesionistë, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi

të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave në territorin e palës kontraktuese respektive.

2. Lista kombëtare e shoferëve profesionistë duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për çdo shofer:

- emri i plotë;
- data dhe vendi i lindjes;
- emri i shoqërisë;
- numri i pasaportës dhe vlefshmëria e saj;
- numri i patentës së shoferit , data e lëshimit dhe/ose e skadimit.

3) Palët kontraktuese të cilat do të hartojnë listën kombëtare të shoferëve profesionistë të parashikuar në nenin 1, paragrafi 1, duhet t'ua komunikojnë ato nëpërmjet kanaleve diplomatike BSEC PERMIS. Kjo e fundit duhet të hartojë listën e konsoliduar të listave kombëtare që do t'u dërgohet ministrive të punëve të jashtme të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi. Lista e konsoliduar e marrë nga ministritë e punëve të jashtme të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, do t'u dërgohet autoriteteve kombëtare kompetente për lëshimin e vizave. Pas marrjes së listës së konsoliduar të shoferëve profesionistë, autoritetet e lëshimit të vizave të Palëve Kontraktuese, në parim, nuk do të kërkojnë dokumente shtesë që pyesin mbi statusin e shoferit.

Neni 2

1. Misionet diplomatike dhe konsullore të palëve kontraktuese do të lëshojnë viza për aplikuesit, shoferët profesionistë, shtetas të palëve kontraktuese të angazhuar në transportin ndërkombëtar rrugor në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Misionet diplomatike dhe konsullore të palëve kontraktuese mund të kërkojnë informacion shtesë për dokumentacionin që lidhet me lëshimin e vizës.

3. Vizat me shumë hyrje do të jenë të vlefshme për një periudhë maksimale prej 1(një) viti, duke marrë parasysh periudhën e vlefshmërisë së patentës së shoferit. Palët kontraktuese do të bëjnë të gjitha përpjekjet për përshpejtimin e dhënies së vizave në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit për çdo hyrje do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të çdo pale kontraktuese.

Neni 3

Autoritetet kompetente, në bazë të legjislacionit kombëtar, do t'i zgjasin vizat apo autorizimet e qëndrimit që u lëshohen shoferëve profesionistë, shtetas të palëve kontraktuese të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilët gjatë kalimit tranzit janë në territorin e njërës prej palëve kontraktuese pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së vizës së tyre për shkak të veprimit të forcave madhore.

Neni 4

Asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të zbatueshme dypalëshe apo shumëpalëshe, detyruese për çdo palë kontraktuese, apo zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve kombëtare për lëshimin e vizave të hyrjes, qëndrimin e përkohshëm apo dëbimin e shtetasve të huaj në secilin prej vendeve respektive.

Neni 5

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve mes palëve kontraktuese.

Neni 6

1. Çdo palë kontraktuese mund të propozojë amendamente të kësaj Marrëveshjeje. Amendamenti i propozuar do t'i dorëzohet depozitarit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë te të gjitha palët kontraktuese.

2. Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë kontraktuese që depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit apo miratimit të amendamentit përkatës 30 ditë pas datës në të cilën më shumë se katër palë kontraktuese kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit apo miratimit të amendamentit përkatës pranë depozitarit. Pas kësaj, amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër kontraktuese në datën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit apo miratimit të amendamentit përkatës pranë depozitarit.

Neni 7

1. Çdo palë kontraktuese, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik, mund të vonojë hyrjen në fuqi apo të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje tërësisht apo pjesërisht në drejtim të të gjithave apo disave prej palëve kontraktuese. Vendosja dhe heqja e një mase të tillë duhet t'i komunikohet menjëherë BSEC PERMIS nëpërmjet kanaleve diplomatike, të cilat, si rregull, duhet të njoftojnë të gjitha palët kontraktuese.

2. Një palë kontraktuese, e cila zgjedh të ushtrojë njërën prej masave të renditura në nenin 7 paragrafi 1, mund të mos kërkojë zbatimin e vazhdueshëm të kësaj Marrëveshjeje ndaj shtetasve të saj nga pala kontraktuese kundër shtetasve të së cilës janë marrë masat në fjalë.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje do të hapet për nënshkrim nga qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat mund të bëhen palë në Marrëveshje, në përputhje me procedurat e tyre të brendshme përkatëse nëpërmjet:

i) nënshkrimit pa rezerva të ratifikimit, pranimit apo miratimit;

ii) nënshkrimit me rezerva të ratifikimit, pranimit apo miratimit, të ndjekur nga ratifikimi, pranimi apo miratimi.

2. Qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat bëhen palë e kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi "i", duhet të njoftojnë BSEC PERMIS në lidhje me këtë. Në mënyrë të ngjashme, këto qeveri të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat bëhen palë e kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi "ii", do të depozitojnë një instrument të ratifikimit, pranimit apo miratimit pranë BSEC PERMIS.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën më shumë se katër palë kontraktuese, në përputhje me nenin 8:

i) kanë nënshkruar Marrëveshjen pa rezerva në drejtim të ratifikimit, pranimit apo miratimit dhe kanë njoftuar për këtë BSEC PERMIS nëpërmjet kanaleve diplomatike; ose,

ii) kanë nënshkruar dhe ratifikuar, pranuar apo miratuar Marrëveshjen me rezerva në drejtim të ratifikimit, pranimit apo miratimit dhe kanë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit apo miratimit pranë BSEC PERMIS.

2. Në rast se një nga qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi e ratifikon apo pranon këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, Marrëveshja do të hyjë në fuqi më pas për palën që e miraton, tridhjetë ditë pas depozitimit nga ana e saj e instrumenteve të ratifikimit apo aderimit.

Neni 10

BSEC PERMIS do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshjeje. Ai do t'i njoftojë menjëherë palët kontraktuese në lidhje me:

a) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, si edhe qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat e kanë nënshkruar dhe ratifikuar, pranuar, miratuar atë, apo kanë aderuar në të;

b) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenet 6, 7, 8, 9 dhe 11, si edhe datën e tij efektive;

c) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Çdo palë kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke njoftuar për këtë qëllim BSEC PERMIS gjashtë muaj para.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit e autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 23 tetor 2008, në gjuhën angleze, në një kopje origjinale që do të mbetet e depozituar pranë BSEC PERMIS, e cila do t'i përcjellë një kopje të vërtetuar secilës prej palëve kontraktuese.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
Lulzim Basha, Ministër i Punëve të Jashtme
Në emër të Qeverisë së Republikës së Armenisë:
Edward Nalbandian, Ministër i Punëve të Jashtme
Në emër të Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit
Në emër të Qeverisë së Republikës së Bullgarisë
Në emër të Qeverisë së Gjeorgjisë
Në emër të Qeverisë së Republikës Greke
Në emër të Qeverisë së Republikës së Moldavisë:
Valeriu OSTALEP, Zv. Ministër i Punëve të Jashtme dhe Integrimit Evropian
Në emër të Qeverisë së Rumanisë
Në emër të Qeverisë së Federatës Ruse
Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë
Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë:
Ali BABACAN, Ministër i Punëve të Jashtme
Në emër të Qeverisë së Ukrainës